

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Qytetarët kërkojnë dorëheqjen, Rama: Asgjë nuk do të më ndalë
ADRESA	https://dosja.al/politike/qytetaret-kerkojne-doreheqjen-rama-asgje-nuk-do-te-me-ndale-i516334
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 13:29:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 13:17:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	aa45084b273b42b5b74c3a669706aab696c2e7620e961cf5474825c1b6c23298
TEKSTI	9860687032d1cc014586e88983bfff0654275f3de48a2a8406d62dc548183d1b9
PAMJA	0ddbc092174122ec614b9100ba29c1713a73f5392c24b79fb71be0128b323e0f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d82d952d03014afe778f80b7126e7857c008194d7b7d1e8bec5e8abb05a066ed
E MËPARSHMJA	5c1221c6713ba7f23b0e25fc1f70162283cd51ebf915bae0edb991fee42ece77
RRËNJA MERKLE	9def72ec67cc19e19d7afd7b89aaceb893ee05eec68643756bafa9738daebd45d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d82d952d03014afe778f80b7126e7857c008194d7b7d1e8bec5e8abb05a066ed>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

1 MINUTA ME PARE

Kryeministri anuloi konferencën me gazetarët, Berisha: Kapitullim pa kushte i Ramës. Bardhi: Përgjegjësia nuk shmanget

1 ORE ME PARE

Rama sulmon mediat dhe Opozitën, mbron Vlora Hysenin por nuk e përmend Agasin: Masa ishte ekstreme, llogaria me drejtësinë është personale

18 ORE ME PARE

"Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare"/ Rama për protestën në SHBA: U ndjeva si në Tiranë, njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur me vezë

21 ORE ME PARE

Dita e 119-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

Politike

Qytetarët kërkojnë dorëheqjen, Rama: Asgjë nuk do të më ndalë

Në mesazhin e tij nga Rinasi, Rama foli për zhvillimet në drejtësi dhe luftën kundër korrupsionit, duke e cilësuar procesin e vetëpastrimit të sistemit si një ndryshim të rëndësishëm.



27 Shtator 2026, 15:17
Nga I.A



Edi Rama

TIRANË- Kryeministri Edi Rama ka reaguar pas kërkesave për dorëheqjen e tij, duke deklaruar se asgjë nuk do ta ndalë atë dhe se Shqipëria nuk do të kthehet pas. Në mesazhin e tij nga Rinasi, Rama foli për zhvillimet në drejtësi dhe luftën kundër korrupsionit, duke e cilësuar procesin e vetëpastrimit të sistemit si një ndryshim të rëndësishëm.

Ai u shpreh se ndryshimet që po ndodhin janë pjesë e një procesi që nuk mund të kthehet pas.

"Ky adresim lidhet me çka po ndodh me korrupsionin e me drejtësinë, e cila është një prej rezultateve historike të misionit për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian. Korrupsioni vazhdon të jetë një hije e rrezikshme përgjatë rrugës sonë, por ndryshimi historik është se ai sot përballet me një tjetër sistem, ku janë formësuar e po zhvillohen organe që hetojnë, akuzojnë, gjykojnë dhe konfiskojnë në liri e pavaresi të plotë. Deri dje korrupsioni ishte sistemi, sot sistemi po e lufton korrupsionin dhe ky është një ndryshim epokal që ka nisur. Vetëpastrimi i sistemit në këtë fazë ende në formësim të shtetit të ri evropian të Shqipërisë është i zhurmshëm. Madje është nganjëherë edhe i pistë dhe shpeshherë po shumë i dhimbshëm.

Ai prek e lëndon edhe individë të pafajshëm, ashtu sikundër keqtrajton e dehumanizon këdo edhe të fajshmit. Por vetëpastrimi i sistemit është një zhvillim i shumëpritur në organizmin e shtetit, pas një agonie tejte të gjatë sa historia e shtetit shqiptar. Organizmi i shtetit po fiton imunitet nga sëmundjet e vjetra, e kur kjo fazë e zhurmshme, e pistë dhe e dhimbshme të ketë kaluar, kur emrat, sekretet, jargët, shkrofëtimat e piskamat e tezgave mediatike të jenë fashitur, kur tymrat e pasqyrave digjitale të jenë shpëmdarë e pluhurat e kantierit të Reformës në Drejtësi të jenë tretur, atëherë do ta shohin se këto zhvillime, janë pjesë jetike e ndryshimit rrënjësor pa kthim ku po ecën sot Shqipëria. Sot unë jam kthyer në Shqipëri, po Shqipëria nuk kthehet pas. Askush dhe asgjë nuk do ta ndalë, nuk do të na ndalë, nuk do të më ndalë", tha Rama./Dosja.al

edi.rama

editoriale

Auron Janku

"Washingtonët" tanë

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Në vëmendje

POLITIKE 27 SHTATOR 2026, 15:07

Reforma në Drejtësi/ Rama: Pa mua, SHBA-ja dhe BE-ja do kishin bërë Noc Rrokun

POLITIKE 27 SHTATOR 2026, 13:45

Xing në Rinas/ Rama vjen nga SHBA, Berisha largohet për në Strasburg (VIDEO)

Sondazh

Poll

Politike

27 Shtator 2026, 15:12

Rama sulmon 2 televizione: Lavatriçe mediatike, kanë marrë peng një Prokurori

Edi Rama TIRANË- Kryeministri Edi Rama ka sulmuar 2 media gjatë fjalimit të tij në Rinas. Rama i ka akuzuar këto televizione p&eum...

Reforma në Drejtësi/ Rama: Pa mua, SHBA-ja dhe BE-ja do kishin bërë Noc Rrokun

Politike

27 Shtator 2026, 15:07

Rama shmangu gazetarët në Rinas, Bardhi: Llogaridhënia nuk negociohet dhe përgjegjësia nuk shmanget

Politike

27 Shtator 2026, 15:02



Rama sulmon deputetët: Pisanjosë me kostum parlamentar, dhuratat e mia janë pronë e shtetit

Politike

27 Shtator 2026, 14:54



Rama bën ironi me Opozitën: Qeveria gjykohet nëse lë drejtësinë të bëjë punën

Politike

27 Shtator 2026, 14:45

POLITIKE 27 SHTATOR 2026, 13:38

Çfarë po ndodh në Rinas? Rama lë gazetarët jashtë dhe anulon konferencën, video-mesazhi shpërndahet me regji nga Kryeministria

më të klikuarat

Çfarë po ndodh në Rinas? Rama lë gazetarët jashtë dhe anulon konferencën, video-mesazhi shpërndahet me regji nga Kryeministria

Shpresë për familjen Kotorri/ Emisioni italian publikon foton e ngjashme me Rajmonda Kotorrin që u zhduk 16 vjeçe në Itali

Shisnin drogë pranë shkollave në Tiranë, goditen disa grupe! 31 të arrestuar, 14 të tjerë në kërkim (VIDEO)

Eriselda Sefa e korrigjon këngën për Enver Hoxhën me Cilevion, reperti koncert falas në Lushnjë

insights

Bledian Koka

Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj

Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by tomorrow



Politike

27 Shtator 2026, 14:42

"Nesër do takoj KM"/ Rama u turrent mediave dhe SPAK: Prokurorët po përdorin gazetarë kamikazë

Edi Rama TIRANË- Kryeministri Edi Rama ka kritikuar mënyrën se si informacionet nga hetimet e drejtësisë bëhen publike në...



Arrestimi i Vlorë Hysenit, Rama: Llogaria e hapur me drejtësinë është çështje personale

Politike

27 Shtator 2026, 14:39



Rama i përgjigjet opozitës dhe sulmon mediat: Emërimi i Hysenit në SHISH u bë pasi punoi si këshilltarë sigurie

Politike

27 Shtator 2026, 14:38



"Arrestimi i Hysenit shtangu partnerët"/ Rama: Mbrojtja e institucioneve, detyrë e shtetit

Politike

27 Shtator 2026, 14:34



"Të dhënat hetimore vërshuan në rrjete sociale"/ Rama sulmon mediat: SHISH u ekspozua ndaj një dëmi të madh që duhej parandaluar

Politike

27 Shtator 2026, 14:29

MË SHUMË



Rama sulmon deputetët:
Pisanjosë me kostum
parlamentar, dhuratat e mia
janë pronë e shtetit



Rama bën ironi me Opozitën:
Qeveria gjykohej nëse lë
drejtësinë të bëjë punën



Arrestimi i Vlorë Hysenit,
Rama: Llogaria e hapur me
drejtësinë është çështje
personale



Rama u turrte mediave dhe
SPAK: Prokurorët po
përdorin gazetarë kamikazë

Rama sulmon deputetët: Pisanjosë me kostum
parlamentar, dhuratat e mia janë pronë e shtetit

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MEMBERSHIP TIGA

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.